LIGJ
Nr.9956, datë 17.7.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN "PËRBALLIMI DHE ZBUTJA E RREZIKUT NGA FATKEQËSITË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin "Përballimi dhe zbutja e rrezikut nga fatkeqësitë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5834, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIARE

(PROJEKTI PËR PËRBALLIMIN DHE ZBUTJEN E RREZIKUT NGA KATASTROFAT)
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE
SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Marrëveshje e datës _____, 200_, ndërmjet Shqipërisë (Përfituesit) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqatës).

Duke pasur parasysh se:

A) Shoqata ka marrë një letër të politikave të zhvillimit më datën ____ maj 2008 nga Përfituesi, ku përshkruhen programi i veprimeve, objektivat dhe politikat (programi), i cili synon të forcojë kapacitetet kombëtare në përgatitje dhe përgjigje ndaj katastrofave dhe në të cilën deklarohet angazhimi i Përfituesit për implementimin e këtij programi;

B) Përfituesi ka kërkuar mbështetjen e Shoqatës në implementimin e projektit nëpërmjet një sërë huash[1] për një periudhë afërsisht 8-vjeçare, e cila do të përdoret nga Përfituesi në implementimin e programit;

C) Duke qenë se Përfituesi mbetet i kënaqur me realizueshmërinë dhe prioritetin e fazës së parë të Programit (Projekti) të përshkruar në listën 1 bashkëngjitur kësaj

[1] Aktivitetet vijuese për fazën e dytë do të paraqiten në shtojcën bashkëngjitur letrës plotësuese të Marrëveshjes së huasë.

Marrëveshjeje, i ka kërkuar Shoqatës asistencën e vet në financimin e këtij projekti;

D) Përfituesi i ka kërkuar Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Bankës) të japë asistencë shtesë në financimin e projektit me anë të një Marrëveshjeje të së njëjtës datë nëpërmjet Palëve, midis Përfituesit dhe Bankës (Marrëveshje e huasë), Banka bie dakord t'i sigurojë Përfituesit një hua të tillë në një shumë prej 2 milionë euro (2 000 000 euro) (Hua): dhe

duke pasur parasysh që Përfituesi dhe Shoqata nëpërmjet kësaj bien dakord që:

Neni I

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti e kërkon ndryshe, terminologjia në shkronja kapitale e përdorur në këtë Marrëveshje ruan po atë kuptim që i është caktuar asaj në kushtet e përgjithshme, si dhe në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Financimi

2.01 Shoqata bie dakord t'i japë Përfituesit, sipas afateve dhe kushteve të paraqitura ose të përmendura në këtë Marrëveshje, një kredi në shumën prej tre milionë e tetëqind mijë të drejta të veçanta tërheqjeje (3,800,000 SDR) (Kredia) për të ndihmuar në financimin e projektit.

2.02 Përfituesi mund të tërheqë shumën e financimit në përputhje me seksionin IV të programit 2 bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Norma e tarifës së angazhimit maksimal financiar e pagueshme nga Përfituesi në bilancin e patërhequr të financimit do të jetë me ½ e përqindjes (1/2 of 1%) në vit.

2.04 Tarifa e shërbimit e pagueshme nga Përfituesi në bilancin e kredisë së patërhequr do të jetë e barabartë me ¾ e përqindjes (3/4 të 1 %) në vit.

2.05 Datat e pagesës janë 15 mars dhe 15 shtator në secilin vit.

2.06 Sasia kryesore e kredisë do të shlyhet në përputhje me programin e shlyerjes të paraqitur në programin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Monedha e pagesës do të jetë euro.

Neni III

Projekti

3.01 Përfituesi deklaron angazhimin e tij në arritjen e objektivave të projektit dhe të programit. Për këtë qëllim, Përfituesi: i) do të realizojë: A) pjesët 1 dhe 5 të projektit me anë të MB-së; B) pjesa 3 e projektit do të realizohet nga MPBTT; dhe C) pjesa 4 e projektit do të realizohet nga MF; dhe (ii) të bëjë që pjesa 2 e projektit të realizohet nga IEUM, të gjitha në përputhje me dispozitat e nenit IV të kushteve të përgjithshme.

3.02 Duke mos vendosur kufizime ndaj dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, përjashtuar rastet kur Përfituesi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Përfituesi duhet të sigurojë që projekti të realizohet në përputhje me dispozitat e

programit 2 bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV
Masa ndreqëse nga Shoqata

Ngjarje të tjera që çojnë në pezullim përbëhen nga sa më poshtë:

a) Një situatë ka lindur që e bën të pamundur implementimin e një pjese të projektit apo një pjese përbërëse të tij.

b) Kur IEUM nuk realizon detyrimet e veta sipas Marrëveshjes së ekzekutimit.

c) Si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, një situatë e jashtëzakonshme ka lindur që do ta bëjë të pamundur punën e IEUM në realizimin e detyrimeve sipas Marrëveshjes së ekzekutimit.

d) Përfituesi ose ndonjë autoritet tjetër që ka juridiksion mund të ketë marrë ndonjë veprim për shkrirjen ose shpërbërjen e IEUM-së ose për pezullimin e aktiviteteve dhe veprimeve të tij.

e) Kur ndonjë dispozitë e legjislacionit të funksionimit të IEUM-së është amenduar, hequr përkohësisht, shfuqizuar, anuluar apo nuk merret parasysh dhe që cenon materialisht dhe në mënyrë të pafavorshme aftësinë e IEUM-së në realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e ekzekutimit.

f) Kur ndonjë dispozitë e vendimeve në rast emergjencash është amenduar, hequr përkohësisht, shfuqizuar apo anuluar, ose kur ndonjë ligj, dekret apo legjislacion ose instrument i njëjtë është adoptuar, i cili cenon materialisht dhe në mënyrë të pafavorshme biznesin, veprimet dhe detyrat e kompanisë së sigurimeve ndaj rreziqeve katastrofike në Europën Juglindore.

Neni V
Hyrja në fuqi, përfundimi

5.01 Kushtet e tjera të hyrjes në fuqi përbëhen nga sa më poshtë:

a) Marrëveshja e ekzekutimit është realizuar në emër të Përfituesit dhe të IEUM-së; dhe

b) Përfituesi, me anë të MB-së, do të krijojë grupin e menaxhimit të projektit siç përshkruhet në paragrafin 3 të seksionit I.A të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje sipas kushteve të referencës dhe me përbërje që do të jetë e pranueshme nga Shoqata.

5.02 Çështja ligjore shtesë përbëhet vetëm nga ajo që vijon, kryesisht, se Marrëveshja e ekzekutimit është autorizuar sipas rregullave nga Përfituesi dhe nga IEUM dhe është ligjërisht e detyrueshme për Përfituesin dhe IEUM në përputhje me afatet dhe kushtet.

5.03Afati i hyrjes së fuqi është nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

5.04 Për qëllime të seksionit 8.05 (b) të kushteve të përgjithshme, data në të cilën detyrimet e Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përjashtuar ato që sigurojnë detyrimet e pagesës) do të përfundojnë brenda 20 vitesh pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI
Përfaqësuesi, adresat

6.01 Përfaqësuesi i Përfituesit është:
6.02 Adresa e Përfituesit është:
Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë
Shqipëri
Faksimil:
(355)-42-228494
6.03. Adresa e Shoqatës është:
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Adresa postare:	Teleks:	Faksimil:
INDEVAS	248423 (MCI)	(1)-202-477-6391
Washington, D.C.		

Nënshkruar në _____, _____, sipas datës dhe vitit që shkruhet më lart midis:
SHQIPËRISË
Nga
Përfaqësuesi i autorizuar
dhe
SHOQATËS SË ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR
Nga
Përfaqësuesi i autorizuar

PROGRAMI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është forcimi i kapaciteteve institucionale (i) reduktimi i rrezikut/pikave të dobëta të përfituesit të huasë ndaj katastrofave natyrore apo atyre të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut; dhe b) kufizimi i humbjeve njerëzore, ekonomike dhe financiare ndaj këtyre katastrofave.

Projekti përbën fazën e parë të programit dhe përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Gatishmëria ndaj dhe menaxhimi i rrezikut të katastrofave

Realizimi i një programi në mbështetje të krijimit të kapaciteteve në përgjigje të situatave emergjente nëpërmjet sigurimit të pajisjeve të nevojshme dhe forcimit të planifikimit për zbutjen e rrezikut të katastrofave, duke përfshirë në mënyrë specifike elementët e mëposhtëm:

1. Forcimi i planifikimit të zbutjes së rrezikut të katastrofave dhe menaxhimi i situatave të jashtëzakonshme

a) Realizimi i rishikimit dhe përditësimit të kuadrit ligjor të vendit lidhur me reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe rishikimet e ligjit të vitit 2001 mbi shërbimet e emergjencave civile, rishikimin e draftlegjislacionit, hartimin e kuadrit themelor rregullator dhe propagandimin e ligjit të ri të propozuar te partnerët e duhur.

b) Zhvillimin e një strategjie kombëtare për menaxhimin e rrezikut të katastrofave dhe programin e investimeve me synim formulimin e një seti prioritar të investimeve kryesore në zbutjen dhe përballimin e situatave të jashtëzakonshme.

c) Përgatitjen dhe implementimin e ndërgjegjësimit publik dhe fushatave arsimore që përfshijnë: i) rritjen e ndërgjegjësimit publik nëpërmjet hartimit të kurrikulave shkollore lidhur me përgatitjen në rast katastrofash, botimin e materialeve arsimore dhe trajnimin e mësuesve në zbatim të kësaj kurrikule; dhe ii) hartimin e strategjive multimediatike të komunikimit publik duke përdorur, mes të tjerash, radion, televizionin dhe internetin.

2. Forcimi i reagimit/përgjigjes ndaj situatave të jashtëzakonshme

a) Realizimi i një vlerësimi formal të nevojave për pajisje që përdoren në rast situatash të jashtëzakonshme dhe, në bazë të tyre, sigurimi i pajisjeve për grupet e kërkim-shpëtimit në zonat urbane, operacionet e shpëtimit në rast përmbytjesh, ose në rast të bllokimit të zonave malore nga dëbora, si dhe pajisje të mbrojtjes personale dhe krijimi i një qendre të lëvizshme operacionale.

b) Forcimi i qendrave ekzistuese të operacioneve në rast situatash të jashtëzakonshme, përfshirë sigurimin me pajisje të qendrës kombëtare të operacioneve dhe asistencë teknike për krijimin e tri qendrave operacionale rajonale, përfshirë vlerësimet e nevojshme të impaktit në mjedis dhe të atyre në jetën e njerëzve.

c) Realizimi i studimeve të fizibilitetit dhe projekteve për krijimin e një sistemi të integruar të thirrjeve telefonike në rast katastrofash "112" dhe të një sistemi të komunikimit në rast emergjencash, veçanërisht krijimin e një sistemi të komunikimit me radio.

d) Hartimi i procedurave të detajuara që ndiqen në përgjigje të situatave të jashtëzakonshme për të bërë të mundur ndërhyrjet e shpeshta dhe të efektshme në rast ngjarjesh me përmasa katastrofike.

e) Sigurimi i trajnimit të specializuar për personat që reagojnë të parët ndaj situatave të jashtëzakonshme, si dhe sigurimi i rekomandimeve për reagime të duhura, përfshirë aktivitete ushtrimore për mbrojtjen civile, skuadrat zjarrfikëse dhe personelin mjekësor.

Pjesa 2: Forcimi i shërbimeve hidro-meteorologjike

Realizimi i një programi në mbështetje të reduktimit të rrezikut ndaj katastrofave përmes sigurimit të parashikimeve dhe shërbimeve të sakta hidro-meteorologjike që u përgjigjen më mirë nevojave të drejtuesve të risqeve katastrofike në sektorin e parashikimit të motit që përfshijnë:

1. Forcimi i aksesit ndaj të dhënave

Krijimi i lidhjeve të telekomunikacionit dhe shërbimeve kompjuterike në Institutin e Mjedisit, Ujërave dhe Energjisë të cilat duhet të jenë të përshtatshme për komunikim në kohë reale me stacionet në terren, modelim të modernizuar dhe me rezolutë më të lartë të shërbimeve meteorologjike, si dhe menaxhimin e ndarjen e një volumi të madh të dhënash mbi motin dhe klimën, si brenda territorit të Përfituesit, ashtu dhe me partnerët e tjerë të Organizatës Botërore Meteorologjike. Kjo qendër do të përbëhet nga instalimi i një rrjeti të shëndoshë intraneti (brenda rrjetit) i aftë për të mbështetur funksionet parashikuese të IEUM-së, krijimin, lidhjen në rrjet, menaxhimin e të dhënave, krijimin e serverëve të aplikimit, stacionet për stafin, furnizim pa ndërprerje me energji elektrike, përmirësim në lidhjet e telekomunikacionit nga stacionet në terren me stacionin qendror, pajisje për menaxhimin e të dhënave, përfshirë instalimin e skanerit, softuerëve dhe stacioneve për arkivimin e të dhënave të kaluara, si dhe kontrollin cilësor

e arkivimin e të dhënave aktuale dhe krijimin e një uebsajti dinamik për të paraqitur dhe ndarë të dhënat dhe parashikimet atmosferike.

2. Përmirësimi i rrjetit të monitorimit dhe parashikimit të motit

Forcimi i rrjetit të monitorimit të sipërfaqes përfshirë atë tek IEUM, MM, si dhe tek Agjencia e Trafikut Ajror për të rinovuar stacionet meteorologjike ekzistuese dhe për të siguruar stacione meteorologjike dhe hidrologjike monitorimi, si dhe stacione të specializuara apo stacione ultratingull në shtresat sipërfaqësore të ajrit, si dhe një stacion satelitor me lidhje poshtë për të mundësuar një përdorim sa më produktiv të të dhënave satelitore për qëllime të ndryshme.

3. Krijimi i kapacitetit për të përgatitur produkte parashikimi për menaxhimin e katastrofave

Forcimi i kapaciteteve parashikuese të motit pranë IEUM-së, me synim përgatitjen e produkteve bazë më të sakta të parashikimit në harmoni me menaxhimin e katastrofave nëpërmjet sigurimit të softuerëve, trajnimin dhe kompjuterizimin e burimeve të nevojshme për të ndërmarrë një model të motit në një zonë lokale në vend dhe në bazë të saj për të forcuar shërbime, si informimin në kohë për dukuri atmosferike të pafavorshme me rezolutë më të lartë dhe kohë fillimi dhe përfundimi të dukurisë atmosferike në lidhje me kushtet e përmbytjeve dhe mbulimin me shtresë dëbore bazuar në parashikimin e reshjeve të shiut, paralajmërime për zjarre të shkaktuara nga moti, njoftime lidhur me kushtet e rrugës nën efektin e motit dhe njoftime për ngrica/thatësira për bujqësinë.

Pjesa 3: Krijimi i kodeve të ndërtesave

Realizimi i një programi për të reduktuar rreziqet nga katastrofat nëpërmjet hartimit të kodeve të përmirësuara dhe krijimit të mekanizmave për futjen e standardeve të përmirësuara, duke përfshirë:

1. Hartimin e një kodi kombëtar të ndërtesave

Realizimi i një rishikimi të legjislacionit të kodeve të ndërtesave, i cili aktualisht është në shqyrtim e sipër ku fokusi vihet tek kriteret e aplikueshme të projektimit ndaj tërmeteve, përfshirë asistencën për adoptimin e kodeve të Bashkimit Europian në vend.

2. Trajnimi ndaj inxhinierëve në standardet e reja të projektimit

Hartimi i materialeve të trajnimit për të trajnuar inxhinierë në kodet e reja të rishikuara të ndërtimit dhe trajnimi i mësuesve.

3. Zhvillimi i një mekanizmi për licencimin e inxhinierëve

Zhvillimi i një sistemi për të certifikuar, licencuar dhe rishikuar licencat për inxhinierët e projektimit dhe të mbikëqyrjes.

Pjesa 4: Kompania e sigurimeve të katastrofave në Europën Juglindore

1. Sigurimi i anëtarësimit të përfituesit në CRIF

Sigurimi i financimit për pagesën e anëtarësimit dhe pjesëmarrjes së Përfituesit në CRIF me synim sigurimin e aksesit ndaj produkteve financiarisht të përballueshme dhe të besueshme të sigurimeve ndaj katastrofave të cilat reduktojnë ekspozimin fiskal të Përfituesit ndaj fatkeqësive natyrore.

2. Vendosja e pranisë së CRIF në tregun e sigurimeve në Shqipëri

Realizimi i një programi, i cili synon të lehtësojë adoptimin e një kuadri politikash nga ana e Përfituesit, i aftë për të favorizuar funksionimin e CRIF në territorin e vet që përfshin miratimin dhe implementimin e ligjeve dhe rregulloreve në favor të funksionimit të CRIF dhe që lehtëson investimet në arsimin publik dhe ndërgjegjësimin e publikut për dobitë që sjell sigurimi ndaj katastrofave.

Pjesa 5: Menaxhimi i projektit

Sigurimi i mbështetjes në menaxhimin e projektit nëpërmjet financimit të kostove të përzgjedhura të menaxhimit, përfshirë shërbimet e konsulentëve, shërbimet për prokurimet dhe menaxhimin financiar, si dhe monitorimin dhe vlerësimin.

PROGRAMI 2
EKZEKUTIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Masat për implementimin e projektit

A. Përgatitja institucionale

1. Ministria e Brendshme

Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të jetë përgjegjës për implementimin e projektit si institucioni kryesor përgjegjës për menaxhimin e katastrofave.

2. Komiteti drejtues i projektit

Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë, përmes implementimit të projektit, jo më vonë se data 1 nëntor 2008 një komitet drejtues të implementimit (KDZ) të projektit sipas termave të referencës dhe burimeve të pranueshme nga Shoqata. Komiteti drejtues i implementimit të projektit do të jetë përgjegjës për sigurimin e koordinimit midis sektorëve të ndryshëm, duke monitoruar progresin në implementimin e projektit dhe duke zgjidhur probleme që lidhen me politikat lidhur me menaxhimin e rrezikut të katastrofave, si dhe probleme që lidhen me vonesa në implementimin e projektit. KDZ do të kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm. Në përbërje të tij do të ketë përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile të Ministrisë së Brendshme, Drejtori i Institutit të Energjisë, Ujërave dhe Mjedisit, Shefi i Shërbimit të Parashikimit të Motit të Komandës së Forcave Ajrore, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Trafikut Ajror, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile që shërben si Sekretariati i Projektit dhe Drejtoria e Strategjisë dhe Koordinimit të Donatorëve pranë Këshillit të Ministrave në rolin e vëzhguesit.

3. Grupi i menaxhimit të projektit

Përfituesi, përmes Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë gjatë implementimit të projektit një grup të menaxhimit të projektit (GMP) sipas termave të referencës dhe me burime të mjaftueshme të pranueshme nga ana e Shoqatës. Grupi i sipërpërmendur do të përgjigjet për menaxhimin e projektit pranë Ministrisë së Brendshme, si dhe për prokurimet, menaxhimin financiar dhe monitorimin e projektit në tërësi. Në përbërjen e grupit bëjnë pjesë stafi i emëruar nga vetë Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, ekspertë të kontraktuar për menaxhimin financiar dhe menaxhimin e prokurimeve, si dhe një koordinator i grupit të implementimit nga IEUM, MPPTT dhe MF respektivisht, për të koordinuar aktivitetet e agjencisë me grupin e menaxhimit të projektit.

4. Grupi (grupet) e implementimit

Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë, përmes implementimit të projektit, jo më vonë se data 1 nëntor 2008 një grup zbatues brenda IEUM-së, MPPTT-së dhe Ministrisë së Financave sipas termave të referencës dhe me burime të pranueshme nga Shoqata. Secili grup zbatues do të jetë përgjegjës për të kontribuar ndaj elementeve kryesore, të implementimit të pjesës përkatëse të projektit, duke formuluar termat e referencës për aktivitetet respektive, duke marrë pjesë në komisionet e vlerësimit dhe miratimit të kontratave për firmë nga zyrtari i autorizuar i

projektit. Çdo grup implementimi do të kryesohet nga koordinatori i grupit të implementimit dhe do të përfshijë specialistë sektori.

5. Grupi i punës për strategjinë e zbutjes së rrezikut ndaj katastrofave

Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë, përmes implementimit të projektit, jo më vonë se data 1 tetor 2008, një grup pune për strategjinë e zbutjes së riskut të katastrofave sipas termave të referencave të pranueshme nga Shoqata dhe që përfshinë përfaqësues nga të gjitha ministritë që merren me zbutjen e riskut të katastrofave. Ky grup pune do të ketë përgjegjësinë që të përgatisë strategjinë kombëtare të zbutjes dhe përballimit të riskut të katastrofave të përmendura në paragrafin 3 të pjesës b të seksionit 1.

6. Grupi i punës i sigurimit të katastrofave

Me synim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në CRIF, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas krijimit të CRIF, Përfituesi do të formojë një grup pune për sigurimin ndaj katastrofave, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të MF-së, të Autoritetit Mbikëqyrës të Institucioneve Financiare Jobankare dhe agjenci të tjera qeveritare dhe/ose institucione të tjera të përshtatshme. Grupi do të drejtohet nga kryetari i përzgjedhur nga MF-ja, i cili përfaqëon edhe Përfituesin në bordin e guvernatorëve të CRIF-së.

B. Modalitetet e implementimit

1. Pjesa e 2 e projektit: IEUM

I. Marrëveshje ekzekutimi

a) Me synim realizimin e pjesës 2 të projektit, Përfituesi, përmes MB-së do të nënshkruajë një marrëveshje ekzekutimi me IEUM-i sipas afateve dhe kushteve të pranueshme nga Shoqata, duke realizuar masat e nevojshme për ekzekutimin e pjesës 2 të projektit nga IEUM-i. Gjithashtu IEUM-së do të marrë përsipër që të botojë në faqen zyrtare elektronike të dhënat në bazë të ndryshoreve meteorologjike nga stacioni meteorologjik i cili është pajisur me aparatura dhe/ose lidhje telekomi sipas projektit.

b) Përfituesi do të ushtrojë të drejtat e veta sipas Marrëveshjes së ekzekutimit në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Përfituesit dhe të Shoqatës dhe të përmbushë synimet e kredisë. Në rast se Shoqata bie dakord në formë të ndryshme nga sa këtu, atëherë Përfituesi nuk do të nënshkruajë, amendojë, shfuqizojë ose të heqë dorë nga Marrëveshja e ekzekutimit ose nga ndonjë prej dispozitave.

II. Kontratat e zbatimit

a) Jo më vonë se 31 janari 2010, Përfituesi, përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, do të marrë të gjitha masat për të siguruar që IEUM-i të botojë në kohë reale në faqen elektronike zyrtare të dhënat për të gjitha ndryshoret meteorologjike nga stacioni meteorologjik, i cili është pajisur me aparatura dhe/ose lidhje telekomi sipas projektit.

b) Pa pasur ndonjë kufizim ndaj dispozitave të seksionit 4.03 të kushteve të përgjithshme, duke filluar me vitin fiskal 2008, si dhe gjatë gjithë fazave të implementimit të projektit, Përfituesi, përmes MASH-it do të marrë të gjitha masat e kërkuara që të sigurojë mbështetjen financiare të mjaftueshme për IEUM-in në mënyrë që të lehtësojë funksionimin e qëndrueshëm të aparaturave të reja dhe të atyre ekzistuese të kërkuara nga IEUM-së sipas projektit

c) Përfituesi, përmes MM-së, MASH-it dhe MPPTT-së, respektivisht, do të përfundojë jo më vonë se 30 nëntori 2008, një marrëveshje, sipas afateve dhe kushteve të pranueshme nga Shoqata, midis Shërbimit Sinoptik brenda MM-së, IEUM-së dhe Agjencisë së Trafikut Ajror e cila: (i) ndihmon IEUM-së për të siguruar të dhëna dhe për

të parashikuar në faqen elektronike publike; dhe (ii) të paraqesë të dhënat ku ndahen përgjegjësitë dhe rolet mes palëve.

2. Pjesa 4.1 e projektit: Marrëveshja Bilaterale për Shpërndarjen e Produktit Lokal

Përfituesi, përmes MB-së, do të kërkojë që Komisioni Shqiptar i Sigurimeve të përfundojë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data e hyrjes në fuqi, një marrëveshje bilaterale me CRIF-in që do të aftësojë CRIF të shpërndajë shërbimet e veta përmes kompanive të sigurimeve lokale sipas afateve dhe kushteve të pranueshme nga Shoqata.

3. Strategjia për përballimin dhe zbutjen e rrezikut të katastrofave

Përfituesi, përmes MB-së, do të përgatisë, jo më vonë se 31 janari 2010, një draftstrategjie të përballjes dhe zbutjes së riskut të katastrofave, e pranueshme nga Shoqata, e cila do t'i japë prioritet në mënyrë të duhur veprimeve dhe investimeve në zbutjen e riskut të katastrofave.

C. Masa kundër korrupsionit

Përfituesi do të sigurojë që projekti të realizohet në përputhje me dispozitat e udhëzimeve kundër korrupsionit.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit

A. Raportet e projektit

1. Përfituesi përmes MB-së do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e projektit dhe do të përgatisë raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 4.08 të kushteve të përgjithshme dhe në bazë të treguesve të monitorimit dhe vlerësimit. Çdo raportprojekt do të mbulojë një semestër kalendarik dhe do t'i paraqitetet Bankës jo më vonë se raport projekti një (1) muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga një raport i tillë.

2. Duke u nisur nga seksioni 4.08 (c) i kushteve të përgjithshme, raporti mbi ekzekutimin e projektit dhe planin e lidhur me të, i kërkuar sipas atij seksioni, do t'i paraqitet Bankës jo më vonë se data 30 gusht 2012.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe revizioni financiar/auditimet

1. Përfituesi përmes MB-së do të mbajë në funksionim një sistem të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 4.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa vendosur ndonjë kufizim ndaj dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, Përfituesi përmes MB-së do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Shoqatës si pjesë e raportit të projektit jo më vonë se dyzetë e pesë ditë (45) pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik raporte të përkohshme financiare për projektin që mbulon tremujorin në formën dhe përmbajtjen e pranueshme nga Shoqata.

3. Përfituesi përmes MB-së do të auditojë deklaratat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 4.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i deklarateve financiare do të mbulojë një periudhë të një viti fiskal të Përfituesit. Deklaratat financiare të audituara për secilën periudhë do t'i paraqiten Shoqatës jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të secilës periudhë.

C. Raporti afatmesëm

Përfituesi përmes MB-së:

a) do të mbajë në funksion politikat dhe procedurat e mjaftueshme për të aftësuar atë që të monitorojë dhe vlerësojë vazhdimisht në përputhje me treguesit e monitorimit dhe vlerësimit realizimin e projektit dhe arritjen e objektivave.

b) do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Shoqatës: i) sipas termave të referencës të pranueshme nga Shoqata, jo më vonë se 31 dhjetori 2009, një raport i cili integron rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit të kryera sipas paragrafit "a" të

këtij seksioni, mbi progresin e shënuar; ii) aktivitetet e kryera në realizimin e projektit gjatë fazës që paraprin datën e raportit në fjalë; dhe iii) mbi realizimin e veprimeve të përmendura në programin dhe në arritjen e treguesve kryesorë, me synim fillimin dhe realizimin e fazës së dytë të programit, si dhe vendosja e masave të rekomanduara për të siguruar një realizim efikas të projektit dhe arritjen e objektivave gjatë periudhës që vijon një datë të tillë; dhe

c) do të rishikojë me Shoqatën, më ose rreth datës 31 janar 2010, ose në një datë të mëvonshme, siç e kërkojnë procedurat e Shoqatës, raportin e përmendur në paragrafin (b) të këtij seksioni, dhe, pas kësaj, të marrë të gjitha masat e kërkuara për të siguruar një realizim efikas të projektit dhe arritje të objektivave, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit në fjalë dhe sipas mendimeve të Shoqatës për çështjen në fjalë.

Seksioni III. Prokurimet

A. Të përgjithshme

1. Mallrat dhe shërbimet (pa përfshirë shërbimet e konsulentëve). Të gjitha mallrat dhe shërbimet (jo shërbimet e konsulentëve) të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga shuma e financimit do të prokurohen në përputhje me kriteret e vendosura ose të përmendura në seksionin I të udhëzimeve të prokurimeve dhe në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga shuma e financimit do të prokurohen në përputhje me kriteret e vendosura ose të përmendura në seksionet I dhe IV të udhëzimeve të konsulentit dhe në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termat me shkronja kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimit ose metodat e shqyrtimit nga ana e Bankës të kontratateve të veçanta të përmendura në metodën përkatëse të përshkruar në udhëzimet e prokurimit ose udhëzimet e konsulentit sipas rastit.

B. Metodat e veçanta të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve (jo shërbimet e konsulentit).

1. Tenderi ndërkombëtar konkurrues: Përveç rasteve të dhëna në paragrafin 2 më poshtë, të mirat dhe shërbimet (pa përfshirë shërbimet e konsulentëve) do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në bazë të tenderit ndërkombëtar konkurrues.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve (jo shërbimet e konsulentit). Tabela vijuese specifikon metodat e prokurimit, jo tenderin ndërkombëtar konkurrues, të cilat mund të përdoren për të mirat dhe shërbimet (jo shërbimet e konsulentëve). Plani i prokurimit do të specifikojë kushtet nën të cilat do të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Blerja
b) Kontraktimi direkt

C. Metodat e veçanta të prokurimit të shërbimit të konsulentëve

1. Përzgjedhja në bazë të cilësisë dhe kostos. Përveç rastit të përmendur në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në bazë të përzgjedhjes cilësore apo me bazë kostoje.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimit të konsulentëve. Tabela që vijon specifikon metodat e prokurimit, jo përzgjedhjen me bazë cilësie dhe kostoje, të cilat

mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit do të specifikojë rrethanat sipas të cilit do të përdoren këto metoda.

Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimin e konsulentëve
b) Përzgjedhje e bazuar në cilësi
c) Përzgjedhje sipas një buxheti fiks
d) Përzgjedhje me koston më të vogël
e) Përzgjedhje nga një burim i vetëm
f) Përzgjedhje e konsulentëve individualë

D. Rishqyrtimi nga Shoqata i vendimeve të prokurimit

Plani i prokurimit do të përcaktojë këto kontrata, të cilat do t'i nënshtrohen rishqyrtimit paraprak nga Shoqata. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen rishqyrtimit të mëpasshëm nga Shoqata.

Seksioni IV. Tërheqja e shumës së financimit

A. Të përgjithshme

1. Përfituesi mund të tërheqë shumën e financimit në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme të këtij seksioni dhe sipas udhëzimeve shtesë të specifikuara më anë të njoftimi për Përfituesin nga Shoqata (përfshirë "Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet" e muajit maj 2006, e rishikuar herë pas here nga Shoqata dhe që i aplikohet kësaj Marrëveshjeje në vijim të këtyre udhëzimeve) për të financuar shpenzimet e pranueshme siç paraqiten në tabelën e paragrafit 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të duhura që mund të financohen nga shuma e financimit (kategoritë), alokimet e shumës së kredisë për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohet për shpenzimet e duhura në secilën kategori.

Kategoria	**Sasia e kredisë e alokuar (shprehur në SDR)**	**Përqindja e shpenzimeve që do të financohen**
1) Mallra sipas pjesëve 1, 2 dhe 3 të projektit, përveç pjesës 1, 2 këtu	2,320,000	80%
2) Shërbimet e konsulentëve sipas pjesëve 1, 2 dhe 3 të projektit	1,100,000	80%
3) Kostot operative	380,000	100 %
Shuma totale	3,800,000	

3. Për qëllimet e këtij seksioni, termi "Kosto operative" do të thotë shpenzime të bëra për financimin e kostove të mirëmbajtjes së pajisjeve, mallrat e konsumueshme, materialet fizike që lidhen me implementimin e projektit, udhëtimin dhe dietat për konsulentët dhe stafin e grupit të menaxhimit të projektit dhe grupet e zbatimit, karburantin dhe pajisje të tjera apo shpenzime të nevojshme për implementimin e projektit, ashtu siç mund të miratohen nga Shoqata.

B. Kushtet e tërheqjes: Periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të

bëhet në lidhje me pagesat e bëra para datës së lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

2. Data e mbylljes është 28 shkurt 2012.

PROGRAMI 3
TABELA E SHLYERJES

Data e duhur e pagesës	**Sasia kryesore e kredisë së shlyeshme (shprehur si përqindje)***
Në çdo 15 mars dhe 15 shtator Duke filluar më 15 shtator 2018 deri më dhe përfshirë 15 mars 2028	5%

* Përqindjet përfaqësojnë përqindjet e sasisë kryesore të kredisë që do të paguhet, përveç rasteve kur Shoqata mund ta specifikojë në formë tjetër sipas seksionit 3.03 (b) të kushteve të përgjithshme.

SHTOJCA
PËRKUFIZIMET

1. "Agjencia e Trafikut Ajror" do të thotë Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror nën përgjegjësinë e MPPTT (siç përcaktohet këtu).

2. "Udhëzimet antikorrupsion" do të thotë "Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga kredia e IBRD dhe kreditë e grandet e IDA-s, të datës 15 tetor 2006.

3. "Kategori" do të thotë kategoria e vendosur në seksionin IV të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

4. "Udhëzimet e konsulentit" do të thotë "Udhëzimet: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Përfituesi i Bankës Botërore", botuar nga Banka në muajin maj 2004 dhe të rishikuar në tetor 2006.

5. "Drejtoria për Emergjencat Civile" do të thotë Drejtoria në ngarkim të _____brenda MB (siç njihet këtu).

6. "Vendimet për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme" do të thotë vendimi i Këshillit të Ministrave nr.644 të Përfituesit me titull " Kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme" e datës 18 dhjetor 2002, e cila është amenduar në datën e kësaj Marrëveshjeje.

7. "Marrëveshje ekzekutimi" do të thotë Marrëveshje e nënshkruar midis Përfituesit, përmes _____, dhe IEUM-së (siç do të referohet këtu) në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të seksionit 1.B të kësaj Marrëveshjeje, meqenëse kjo mund të amendohet herë pas here.

8. "Kushtet e përgjithshme" do të thotë "Kushtet e përgjithshme të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për Kreditë dhe Grandet", e datës 1 korrik 2005 (e amenduar më 15 tetor 2006).

9. "Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit" ose "IEUM" Instituti për Mjedisin, Ujin dhe Energjisë i Përfituesit, një institucion qeveritar përgjegjës për shërbimet ndaj palëve të treta dhe përgjegjës për transferimin e njohurive dhe të teknologjisë në sektorët e energjisë, ujit, mjedisit dhe sektorët klimatikë.

10. "Legjislacioni për funksionimin e IEUM" do të thotë kolektivisht vendimet e Këshillit të Ministrave të Përfituesit nr.532, datë 1 gusht 2003 dhe nr.560, datë 22 gusht 2007 dhe "Ligjin e përgjithshëm mbi emergjencat civile" të Përfituesit nr.8756, datë 26 mars 2001, e amenduar sipas datës së kësaj Marrëveshjeje.

11. "Marrëveshje huaje" do të thotë marrëveshja e huasë për projektin ndërmjet Përfituesit dhe Bankës, me të njëjtën datë të kësaj Marrëveshjeje, meqë kjo marrëveshje huaje mund të amendohet herë pas here. "Marrëveshja e huasë" përfshin të gjitha shtojcat, programet dhe marrëveshjet plotësuese të Marrëveshjes së huasë.

12. "Viti fiskal" do të thotë dymbëdhjetë (12) muaj që korrespondojnë me vitet fiskale të Përfituesit, periudhë e cila fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor në secilin vit kalendarik.

13. "Ministria e Mbrojtjes" ose "MM" do të thotë Ministria e Mbrojtjes së Përfituesit.

14. "Ministria e Arsimit dhe Shkencës ose "MASH" do të thotë Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Huamarrësit.

15. "Ministria e Financave" ose "MF" do të thotë Ministria e Financave e Përfituesit, ose çdo pasues pas kësaj.

16. "Ministria e Brendshme" ose "MB" do të thotë Ministria e Brendshme e Përfituesit, ose çdo pasues pas kësaj.

17. "Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit" ose "MPPTT" do të thotë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Përfituesit ose çdo pasues pas kësaj.

18. "Monitorimi dhe vlerësimi i treguesve" do të thotë monitorimi dhe vlerësimi i indikatorëve të miratuar siç përshkruhen në letër, e cila do të përdoret nga Përfituesi për të matur progresin e shënuar në implementimin e projektit dhe shkallën e arritjes së objektivave të tij.

19. "Udhëzimet e prokurimit" do të thotë "Udhëzimet: Prokurimet sipas huasë IBRD dhe kredisë IDA" të botuara nga Banka në muajin maj 2004 dhe të rishikuara në tetor 2006.

20. "Plani i prokurimeve" do të thotë plan prokurimesh për projektin, të dates 16 maj 2008 dhe të përmendur në paragrafin 1.16 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.24 të udhëzimeve të konsulentëve, meqënëse të dyja do të përditësohen herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafit të sipërpërmendur.

21. "Kompania e sigurimeve ndaj rrezikut të katastrofave në Europën Juglindore" ose "CRIF" do të thotë programi i sigurimit ndaj rrezikut rajonal të katastrofave i cili do të jetë nën kontrollin e vendeve të Europës Juglindore, ku Përfituesi do të bëhet pjesë sipas pjesës 4.1 të projektit.